



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0032

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani, duke vendosur sipas ankesës së (OE) “Infinit” Sh.P.K.” kundër njoftimit për dhënie të një kontrate të aktiviteti të prokurimit të “Komuna e Gjakovës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri tender - Furnizim me pajisje bujqësisë, teknologjisë ushqimore, hotelerisë ne shkollën profesionale Kadri Kusari” me nr. të prokurimit: “632-23-12909-1-2-1”, me 02/04/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “Infinit” Sh.P.K.” me nr. 2024/32 , kundër vendimit të Autoritetit kontraktues/ Komuna e Gjakovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri tender - Furnizim me pajisje bujqësisë, teknologjisë ushqimore, hotelerisë ne shkollën profesionale Kadri Kusari” me nr. të prokurimit: “632-23-12909-1-2-1”.
2. Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me numër të prokurimit: “632-23-12909-1-2-1” iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Gjakovës dhe lënda kthehet në Ri-vlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 17.11.2023, Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ri tender - Furnizim me pajisje

bujqësisë, teknologjisë ushqimore, hotelerisë ne shkollën profesionale Kadri Kusari” me nr. të prokurimit: “632-23-12909-1-2-1”. Ndërsa me datën 27.12.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate “ E-Company” Sh.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës : 18,000.00 euro.

Me 29.12.2023, “Infinit” Sh.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 29.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 08.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Infinit” Sh.P.K.” me nr. 32/2024 për lidhur me aktivitetin “Ri tender - Furnizim me pajisje bujqësisë, teknologjisë ushqimore, hotelerisë ne shkollën profesionale Kadri Kusari” me nr. të prokurimit: “632-23-12909-1-2-1”.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Infinit” Sh.P.K.” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): Ankuesi pretendon: “Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkëlqen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj. AK/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartcekura dhe Rregulloren për prokurim publik. Zyra e prokurimit KK Gjakove me 27.12. ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues ku është rekomanduar për kontrate OE “E-Company” SH.P.K. ofertuesi me çmimin 17947.80 apo 5462.80 euro me çmim me te larte se oferta e kompanisë sonë. Citoj faktin se për këtë projekt AK ne FDT nuk ka vendosura asnjë kriter lidhur me kapacitetin ekonomik & financiar dhe Kapacitetin teknik & profesional, e vetmja dëshmi e kërkuar është certifikata e regjistrimit te biznesit me informatat shtese te cilën kompania jone ka dorëzuar/plotësuar. Autoriteti kontraktues me 14.12. na drejtohet me B41 Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht te ulet, ku është kërkuar nga AK qe te dorëzojmë deklarate me shkrim duke zbërthyer ne mënyrë te detajuar kalkulimin e çmimit te paraqitur, afati për përgjigje ne letër standarde 1dite apo deri me 15.12. Ky afat është shume i shkurtër dhe jo-ligjor, ne çdo letër standarde ne aktivitetet tjera te prokurimit nga KK Gjakove afati për përgjigje ka qene 5dite. Me 15.12. kemi dërguar deklaratën, përveç deklaratës e cila ka qene kërkesës nga AK po ashtu kemi dërguar ofertat nga furnitorët për këtë pozicion dhe pozicionet tjera ne paramasë ne baze te cilave kemi zbërthyer dhe marzhën e fitimit për këtë aktivitet te prokurimit. Ne letër standarde për eliminim ndaj kompanisë sonë është cekur se Autoriteti kontraktues ka analizuar ne detaje përgjigjen e OE “Infinit” Shpk ku për këtë pozicion nuk ka ofruar sqarime, ky konstatim i AK/komisionit vlerësues nuk qëndron. Ne përgjigjen e dërguar tek AK me 15.12. përveç

deklaratës për sqarime shtese ne kemi dorëzuar/dëshmuar koston e produkteve duke paraqitur 3 oferta nga furnitorë te këtyre pajisjeve. Po ashtu me ane te deklaratës jemi zotuar se projektin do te realizojmë sipas kërkesave te AK ne dosjen e tenderit, ne rast se do te kishim dyshime se nuk mund te realizojmë projektin apo realizimi i projektit do te na shkaktonte humbje financiare ne nuk do te dërgonim përgjigjet tek autoriteti kontraktues. Konform pikës 3 të nenit 61 të LPP-së 3. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë. Kompania jone ka dërguar shpjegim te mjaftueshëm për të elaboruar se oferta jone. nuk është jo-normalisht e ulet, AK nuk ka paraqitur asnjë arsyetim shtese ne letër standarde se ku është bazuar kur ka konstatuar se oferta e kompanisë sonë është jo normalisht e ulet. Ofertat e furnitorëve ku do të furnizohemi me këto pajisje janë dëshmi e mjaftueshme se ne kemi marzhe fitimi rreth 15% për realizimin e këtij projekti dhe AK është dashur të merr për baze dëshmitë e ofruara apo eventualisht nëse nuk ju beson dëshmimeve tona te hulumtoje tregun nëpërmjet kërkimeve ne internet. Nuk mund të jetë bazë për eliminim oferta e OE tjetër e cila është abnormalisht e lartë ne krahasim me kërkesat e parashtruara ne paramase. Ne përgjigjen ne letër standarde kemi deklaruar se marzha e aplikuar për çdo pozicion nuk është e njëjtë por ne projektin e marrim si tërësi dhe furnizimi do te realizohet ne tërësi, ky projekt nuk është kontrate kornize ku AK do te mund te kishte dyshimet se OE nuk mund të realizoj furnizimin për pozicion te caktuar. Ne autoritetin kontraktues “KK Gjakovë” qe nga fillimi i vitit 2020 kemi realizuar 18kontrata, 5 kontrata brenda vitit 2023 dhe asnjë projekt nuk ka dështuar prandaj nuk e di prej nga është krijuar ky perceptim se do te dështojmë ne realizimin e këtij projekti. Neni 1 qëllimi i LPP-se është qe AK te shpenzoje fondet ne mënyrë sa me racionale dhe ekonomike, eliminimi i ofertës sonë dhe shpërblymi me kontrate për OE “E-Company” Sh.P.K. dëmton buxhetin e shtetit përkatësisht AK “KK Gjakovë” për 5462.80euro. Mare parasysh faktet e lartcekura konstatojmë se AK/komisioni vlerësues nuk ka trajtuar barabarte OE ofertues ne këtë aktivitet te prokurimit, kompania jone është eliminuar megjithëse oferta jone plotëson te gjitha kërkesat e parashtruara nga AK si ne njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit. Autoriteti kontraktues nëse ka pasur dyshime se nuk do te realizojmë projektin sipas kërkesave ne DT dhe ne paramase ka mund të kërkojë qe me rastin e nënshkrimit te kontratës te ofrojmë garancion sigurimin e ekzekutimit ne vlere 50%. Mare parasysh faktet e lartcekura konstatojmë se AK/komisioni vlerësues ka eliminuar pa baze ligjore kompaninë tone nga ky aktivitet i prokurimit.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Infinit” Sh.P.K.” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 61 të LPP-së si dhe neni 25 dhe 41 i RrPP-së. Kërkojmë nga Organi shqyrtues i prokurimit qe pas shoshitjes de provave dhe fakteve te aprovoje ankesën si te bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Përgjigje e AK në Kërkesën për rishqyrtim.

Me dt.29.12.2023, Operatori Ekonomik "INFINITT" SH.P.K., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Ri tender - I furnizim me pajisje bujqësisë, teknologjisë ushqimore, hotelerisë në shkollën profesionale Kadri Kusari", Nr. i prokurimit- 632-23-12909-1-2-1 , Nr. i brendshem-632-23-152-121. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me date 29.12.2023, ka shqyrtuar kërkesën ne fjalë si më poshtë: Pretendimet e juaja nuk qëndrojnë, sepse ju keni sjell sqarime, por jo për pozicionin nr.5, për të cilin edhe ju janë kërkuar. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 12.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 32/2024, ndërsa me datë 31.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/32 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK Nuk Pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues ndërsa OE ka deklaruar se Pajtohet me mendimin e eksperteve.

Vlerësimi pretendimit të OE “Infinit” Sh.P.K.” - Eksperti shqyrtues përmes Raportit nr. 2024/32 si në vijim:

Konstatimi i parë (I): “Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë nga Operatori Ekonomike “Infinit” Sh.P.K. të cilat janë të bashkangjitura ne ekspertizë. Duke pare sqarimin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues vërejmë se AK nuk ka zbatuar LPP-ik konkretisht Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin PUBLIK Neni 25 Kriteret e përzgjedhjes pikën 25.9 Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkohej të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më shumë se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se. Operatori Ekonomik ka dorëzuar Sqarimet e kërkuara bashkangjitur gjeni sqarimet. Autoriteti kontraktues nuk ka zbatuar nenin 61 të LPP-se dhe Neni 41 për Tenderët Jo normalisht të Ulët 41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme : i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. Gjë qe asnjëra nga pikat ne ketë rast nuk korrespondon me trajtimin qe Autoriteti Kontraktues ka konstatuar ne ketë rast, duke marre parasysh aludimet apo handesimin e Autoriteti kontraktues, ekspertja shqyrtuese konstaton se gjithmonë duhet te kemi primare nenin 1 te LPP-ik dhe duke u nisur nga ky fakte AK-se për te vlerësuar dhe trajtuar tenderuesit te barabartë ne ketë raste ka mundur te zbatoj Rregullore Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik Neni 29 Siguria e Ekzekutimit 29.4 Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës, ndërsa të kontrata me çmim për njësi apo me poentim kërkohej 10% e vlerës se parashikuar. Kur përcaktohet përqindja e sigurimit të ekzekutimit, në rast të kontratave me vlerë të mesme ose të madhe, AK do të siguroj që përqindja mjafton për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata. Autoriteti kontraktues, pasi që të jetë përputhur me nenin 61 të LPP-së, ka mjaft arsye për të besuar se Operatori ekonomik e ka dorëzuar një tender të pa-zbatueshëm (jo-normalisht të ulët), gëzon të drejtën që përqindjen e kërkuar të sigurimit të

ekzekutimit ta rris për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata. Andaj ekspertja konstaton se pretendimet e tenderuesit janë të bazuara.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin “Ri tender - Furnizim me pajisje bujqësisë, teknologjisë ushqimore, hotelierisë ne shkollën profesionale Kadri Kusari” me nr. të prokurimit: “632-23-12909-1-2-1”. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Infinit” Sh.P.K.” dhe se, argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Infinit” Sh.P.K.” janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ri tender - Furnizim me pajisje bujqësisë, teknologjisë ushqimore, hotelierisë ne shkollën profesionale Kadri Kusari” me numër të prokurimit: “632-23-12909-1-2-1”, të Anullohet Njoftimi për dhënie të kontratës, dhe

lënda të kthehet në Rivlerësim.

Paneli Shqyrtues konstaton se veprimet dhe aktet e Autoritetit kontraktues dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore, në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në Rivlerësim dhe Autoriteti kontraktues, obligohet të veprojë për evitimin e gjitha shkeljeve ligjore, përkatësisht të pretendimeve ankimore të OE “Infinit” Sh.P.K.” të vlerësuara si të bazuara/qëndrueshme sipas Raportit të ekspertit shqyrtues, konstatime të cilat janë të mbështetura nga Paneli shqyrtues, me dispozitat ligjore të LPP-së, kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Kthimi i aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, duke cituar: “Të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - " INFINITT " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: